



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***10 Dhjetor 2015***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



**ZHURNAL** <sup>®</sup>  
Agjenci e Lajmeve

## Inaugurohen investimet në Spitalin e Gostivarit



**Shkup, 9 dhjetor** - Kryetari i Komunës së Gostivarit, Nevzat Bejta i fituar nga drejtori i Spitalit të përgjithshëm “Ferid Murad”, Ylber Ademi mori pjesë në inaugurimin e investimeve të kryera së fundmi në Spitalin e Gostivarit, ndër to edhe ndërimi i derës hyrëse në Njësinë e Urgjencës dhe perdeve mbrojtëse nga diell që Spitali i pranoi si donacion nga Komuna e Gostivarit.

Me këtë rast, kryetari Bejta theksoi se mbetet angazhim i tij, drejtorit dhe bashkëpunëtorëve që përmes qeverisjes qendrore të ndikohen në përmirësimin sa më të madh të kushteve në Spitalin e Gostivarit.

“Shpreh falënderim për drejtorin dhe personelin mjekësor të Spitalit për mikpritjen e treguar. Sot e shoh Spitalin e Gostivarit ndryshe nga herët e tjera, me ambient më të pastër, organizim më të mirë. Ne si Komunë në bazë të ligjit jemi angazhuar të ndajmë mjete financiare për Spitalin e Gostivarit, i cili nuk është nën kompetencat e pushtetit lokal, por angazhohemi dhe bëjmë përpjekje të sigurojmë sa më shumë mjete financiare nga buxheti republikan. Duke i falënderuar drejtorit dhe stafit mjekësor, Spitali i Gostivarit dallohet nga Spitalet e tjera por mbetet angazhimi i jonë i përbashkët që ky spital të tejkalon borxhet e trashëguara nga periudhat e kaluara. Nuk është faji i drejtorit aktual apo drejtorëve paraprak, por më herët nuk është menaxhuar ashtu siç duhet. Nuk hy në grupin e politikanëve të akuzoi se kush çka bëri në të kaluarën, por angazhohemi që bashkërisht ta nxjerrim Spitalin nga kolapsi financiar, pas çka do të vijë në shprehje menaxhimi ende më i mirë”, tha mes tjerash kryetari, Nevzat Bejta.

Po ashtu, përgëzoi shtatë punonjësit në Spitalin e Gostivarit të cilët u pajisen me vendime të përhershme për punë.

Drejtori Ylber Ademi shprehu mirënjohje për përkushtimin e treguar nga drejtuesit e Komunës së Gostivarit për përmirësimin e kushteve për punë të personelit spitalor por mbi gjitha krijimit të kushteve sa më të mira për trajtimin e pacientëve.

“Bëjmë promovimin e disa aparaturave që i siguroam për Spitalin e Gostivarit, dhe njëkohësisht dëshiroj t'i falënderohem Kryetarit dhe Këshillit të Komunës së Gostivarit për donacionin me vlerë mbi 2 mijë euro për rregullimin e derës hyrëse në Njësinë e Urgjencës. Është derë sensorike e cila na ndihmon në aspektin preventiv por edhe në lëvizjen e pacientëve dhe ruajtjen temperaturave të brendshme të objektit. Po ashtu, Komuna ndihmoi në formë donacioni edhe në sigurimin e perdeve të mbi 50 % dritareve të Spitalit, duke



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



shmangur ndikimin e rrezeve të diellit në ambientet e brendshme të objektit. Jam mirënjohës për këtë mbështetje që na ofron Kryetari dhe Këshilli i Komunës së Gostivarit”, tha drejtori Ylber Ademi.

Ademi njoftoi se Spitali lëshoi në përdorim edhe disa pajisje teknologjike dhe mjekësore të siguruar me mjete nga buxheti i Spitalit.

“Spitali u furnizua edhe me lavatriçe respektivisht makina të kapaciteteve të mëdha për larjen dhe terjen e teshave si dhe makinën për hekurosjen e tyre. Është një investim prej 2 milion denarë ose mbi 30 mijë euro. Po ashtu promovuam edhe “eho” aparati jashtëzakonisht të përsosur i cili po ashtu shërben edhe si kolor dopler dhe që shërben për mjekët që punojnë në kabinetin e rëntgenit”, tha Ademi, i cili po ashtu njoftoi se në ditën në vazhdim do të pret në kabinetin e tij drejtorët e Fondit të Shëndetësisë me qëllim të tejkalimit të problemit me borxhet e trashëguara të Spitalit”, tha Ademi.

Spitalit i përgjithshëm “Ferid Murad” në Gostivar, krahas banorëve të regjionit të Gostivarit shërben edhe për banorët e komunave fqinje, siç është Kërçova, Dibra dhe komunat rurale.

## USHT e përmbylli fushatën e aktiviteteve për parandalimin e virusit HIV AIDS

**Tetovë, 9 dhjetor**-Grupi shkencor dhe Parlamenti studentor i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, sot përmes një ligjëratare, me temë „Kundër sidës”, të prezantuar nga studentët, Vjosa Xhaferi dhe Albert Maqellara, e kanë përmbyllur fushatën e aktiviteteve që e kanë organizuar për nder të 1 Dhjetorit, Ditës botërore të luftës kundër sidës.

Në këtë ligjëratë të pranishëm ishin Rektori i USHT-së, Prof. dr. Vullnet Ameti, Sekretari i përgjithshëm, Adem Beadini, shefi i Kabinetit të Rektorit, Mr.sc, Faton Shabani, stafi akademik i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, si dhe studentë të këtij fakulteti dhe të fakulteteve të tjera.

Dekani i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, Doc. dr. Nasir Bexheti i përgëzoi studentët për angazhimin e tyre në aktivitete të cilat për qëllim kanë ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e shëndetit.

„Dua të ju përgëzoj për punën që bën Grupi shkencor i Parlamentit studentor të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, që përkujton dhe shënon ngjarje të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut dhe tema të cilën e trajtojnë sot ata, është një temë që i kushtohet 1 Dhjetorit - Ditës së sidës. Me këtë ligjëratë ata e dëshmojnë edhe njëherë përkushtimin e tyre në informimin dhe sensibilizimin e popullatës në vendin tonë për këto sëmundje, dhe vetëm në këtë mënyrë do të mund t'i parandalojmë këto sëmundje”, tha Doc. dr. Nasir Bexheti.

Stomatologu i sapodiplomuar në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë të USHT-së, Albert Maqellara tha se shumë me rëndësi është mënyra e preventimit dhe trajtimit të virusit HIV AIDS. “Kjo ligjëratë organizohet me rastin e Ditës Botërore të luftës kundër sidës, e cila është më 1 Dhjetor, mirëpo ne në kuadër të kampanjës tonë që ia kemi përkushtuar kësaj sëmundje, kemi realizuar disa aktivitete, ndërsa sot, ne e përmbylim këtë



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



kampanjë me këtë prezantim këtu në Rektoratin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, me një ligjëratë para studentëve të titulluar: „Kundër sidës”. Në këtë prezantim u dhanë disa statistika dhe u sqarua mënyra e preventimit dhe e trajtimit të sidës si sindrom dhe e virusit të HIV-it”, u shpreh Albert Maqellara, stomatolog i sapodiplomuar në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë të USHT-së dhe njëherit Kryetar i Grupit shkencor të këtij fakulteti.

Studentja Vjosa Xhaferi theksoi se me këtë aktivitet përkujtohen të gjitha viktimat që i ka marrë kjo sëmundje, dhe sipas saj, për këtë arsye kjo kampanjë realizohet me moshën studentore, me qëllim që të informohen ata se si mund të transmetohet dhe si mund të parandalohet virusi HIV AIDS. “Dita Botërore e AIDS është më 1 Dhjetor dhe ka për qëllim që t’i përkujtojmë të gjitha viktimat të cilat i ka marrë virusi HIV AIDS, prej momentit kur është paraqitur, që t’i mbështesim të gjithë pacientët të cilët kanë HIV AIDS, dhe të mos i stigmatizojmë ata duke i distancuar prej shoqërisë sonë si njerëz të cilët janë të veçantë ose të ndryshëm prej nesh. Qëllimi, pse ne e bëjmë me moshën studentore është sepse gjëja më e rëndësishme për HIV AIDS-in është të dinë ata se si transmetohet ajo prej një pacienti i cili është i infektuar, te një njeri i shëndoshë, dhe me këtë qëllim ne do të preventojmë ose do të mundësojmë parandalimin e infeksioneve të reja me HIV AIDS, ose paraqitjen e HIV AIDS-it më vonë”, theksoi Vjosa

sa Xhaferi, studente e vitit të pestë të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë.

Ndryshe kjo kampanjë e studentëve të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë është realizuar nën moton „Të fokusohemi, të bashkëpunojmë, të arrijmë gjenerata të reja pa AIDS. Të arrijmë në Zero, Zero infeksione të reja me HIV, Zero vdekje nga AIDS”.

## Ndotjen e ajrit në qytetet e RM-së dhe rreziqet e mundshme ndaj shëndetit të popullatës

**Shkup, 9 dhjetor** - Në kuadër të detyrimeve të rregullta për mbikëqyrje të shëndetit publik të popullsisë në Republikën e Maqedonisë, Instituti i shëndetit publik përgatiti këtë informacion që ka për qëllim informimin e drejtë dhe në kohë të popullatës dhe propozim masat për zvogëlimin e rreziqeve ndaj shëndetit si pasojë e ndotjes së ajrit që ka një tendencë të rritjes.

Këtë vit, si edhe vitet e kaluara, me fillimin e sezonit të ngrohjes po fillojmë një periudhë të episodeve të shpeshta të përqendrimeve të larta të materieve ndotëse në ajër, para së gjithash grimcave PM-10 dhe grimcave 2.5. Pothuajse në të gjitha pikat matëse të rrjetit të stacioneve matëse të Ministrisë të mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor përqendrimet e këtyre grimcave (PM-10) janë për disa herë mbi mesataren e lejuar prej 50 mikrogram/ m<sup>3</sup>. Gjendja është më alarmante në Shkup, Tetovë dhe Manastir. Gjatë javës së kaluar (04-08.12) përqendrimet ditore mesatare të këtyre grimcave në Tetovë kanë qenë nga 246 deri më 387 mikrogram, në Manastir nga 54 deri më 222 mikrogram, ndërsa në Lisiçe (Shkup) nga 18 deri më 208 mikrogram/ m<sup>3</sup>

Burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit në vendin tonë janë: proceset e prodhimit të energjisë elektrike me përdorimin e lëndëve djegëse të ngurta – qymyri dhe atyre në gjendje të lëngët, proceset prodhuese industriale, gazrat që lirohen nga automjetet, si dhe tymi që lirohet gjatë ngrohjes së amvisërive dhe kapaciteteve administrative gjatë periudhës së dimrit. Pjesëmarrja e këtyre burimeve në lirimin ne



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



substancave të ndryshme ndotëse është e ndryshme. Sa i përket oksideve të azotit dhe dioksidit të sulfurit rol më të madh ka prodhimi i energjisë elektrike dhe asaj për ngrohje, ndërsa sa i përket lirimit të grimcave PM10 dhe monoksidit të karbonit - trafiku dhe ngrohja e amvisërive dhe objekteve administrative dhe kompanive të tjera. Në qytete burim shtesë i ndotjes janë edhe aktivitetet ndërtimore gjatë të cilave lirohen sasi të mëdha të pluhurit, pastaj gazrat që lirohen nga deponitë (Tetovë).

Në Tetovë janë evidente përqendrimet e larta të grimcave në ajër, qytet ky që ka një dendësi të madhe të popullsisë (330 banorë në një km<sup>2</sup>, me trafik të dendur, urbanizim joadekuat dhe me një rritje të aktiviteteve ndërtimore, një numër të madh të kapaciteteve prodhuese, ndërsa në afërsi të qytetit ndodhen edhe kapacitetet prodhuese të Silmak dhe Teteks të cilat bashkë me faktorët urban siç është trafiku i dendur, ngrohjen individuale të amvisërive dhe aktivitete ndërtimore) që kontribuojnë në ndotjen e ajrit. Edhe topografia ka një ndikim të madh sepse në fushëgropat vjen deri te paraqitja e mjegullës, nuk ka rrymim të mjaftueshëm të ajrit që do e largonte ajrin e ndotur, por ka edhe inversion të temperaturës me ç'rast materiet ndotëse mbeten në ajër për një kohë më të gjatë.

**Efektet ndaj shëndetit**

Edhe pse organ primar i cili vuan nga ndotja e ajrit janë mushkëritë dhe organet e sistemit të qarkullimit të gjakut, pothuajse nuk ekziston organ i cili nuk vuan nga pasojat e ndikimit të përqendrimeve të larta të grimcave në ajër dhe tek të ashtuquajturat grupe vulnerable (fëmijët nga 0-5 vjet, personat e moshuar, personat me sëmundje kronike, të sëmurët nga astma, personat që punojnë në mjedise të hapura, por edhe duhanpirësit) rreziku nga shfaqja e dëmtimeve të rënda në zemër rritet për 3-4 herë.

Me pjesëmarrje të profesionistë të Bankës Botërore në analizën e të dhënave ekologjike dhe dëshmime mjekësore për lidhshmërinë e ndotjes së ajrit dhe pasojat për shëndetin, në Institutin e shëndetit publik është përllogaritur se rreth 1350 vdekje në vit në vendin tonë, por edhe me mijëra ditë produktive të humbura janë si pasojë e ndotjes së ajrit me grimca. Për çdo ditë njerëzit vuajnë edhe nga sëmundjet e organeve të frymëmarrjes ( astma, bronkiti kronik, etj) të cilat janë shkak për humbjen e shumë mijëra viteve produktive të jetës. Ndotja me grimca ekonominë e Maqedonisë në vitin 2011 e ka dëmtuar për rreth 253 milion euro ose 3,2 përqind të PBB (si rezultat i numrit të madh të vdekjeve të parakohshme, shpenzimeve në shëndetësi, produktivitetit të zvogëluar të popullatës dhe mungesave në vendin e punës).

## **Ndotja në nivele alarmante, javën që vjen gjendje e jashtëzakonshme**

**Shkup, 9 dhjetor** - Edhe mbrëmë ndotja e ajrit ishte në nivele alarmante. Por, kompetentët vlerësojnë se vetëm javën që vjen do të diskutojnë nëse ka nevojë apo jo për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Nëse merret një vendim i tillë, do të duhej të reduktohej orari i punës së shkollave dhe çerdheve.

Nga Instituti i Shëndetit Publik apelojnë që qytetarët të bëjnë kujdes e të reduktojnë daljet e panevojshme në ajër të ndotur, ndërsa punonjësve në sektorin ndërtimor dhe personave me sëmundje kronike të marrin medikamente me rezervë dhe mundësisht të vendosin maska mbrojtëse.

"Me siguri do të duhet të merren masa alarmuese urgjente. Grupi intersektorial javën e ardhshme do



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



diskutojë për masat e ardhshme dhe për nivelin alarmues të ndotjes së ajrit jo vetëm për pesë, por edhe për dy ditët e fundit. Prania e madhe e mikrogramëve në metër kub tregon se situata është tejet brengosëse"- deklaroi Dragan Gjorgjev nga Instituti i Shëndetit Publik.

Situata kërkon qasje sa më serioze dhe afatgjate në parandalimin e kësaj gjendje, thonë nga ky dikaster. Në Tetovë, Shkup, Gostivar, Kërçovë dhe Manastir pa ndërprerë për pesë ditë me radhë është regjistruar dhjetë herë më shumë prania e grimcave PM.

Një ndër metodat më të përfolura në diskutimet e grupit intersektorial është reduktimi i trafikut rrugor, si mundësi shtesë në parandalimin e ndotjes së ajrit dhe për lëndët djegëse që përdoren nëpër shtëpi, siç janë vajrat e automjeteve, plastikat dhe gomat. Nga ndotja e ajrit janë shtuar problemet shëndetësore. 30 deri në 40% më shumë pacientë gjatë stinës së dimrit vuajnë nga sëmundje që lidhen drejtpërdrejt me ndotjen.

## Motrat medicinale nga spitalet private mund të punësohen në ato shtetërorë!

**Shkup, 9 dhjetor** – Motrat medicinale, teknikët të cilët punojnë nëpër institucionet shëndetësore private mund të kthehen në ato shtetërore. Kjo është paraparë me ndryshimet e reja në ligjin për shëndetësi që tashmë punohet në procedurë parlamentare.

Nikola Todorov ka thënë se ka vendosur të bëj ndryshime në ligj sepse me këtë projekt më përpara dhe kthim të mjekëve dhe specialistëve në ato shtetërore ka qenë i suksesshëm. Ai ka sqaruar se ndryshimet në ligjin për shëndetësi bëhen me qëllim që të rritet kualiteti me kuadër profesional.



## Ndotja e ajrit alarmante, shqyrtohet mbyllja e çerdheve



Gjendja me ndotjen e ajrit në Maqedoni është alarmante. Nga Instituti i shëndetit publik alarmojnë se spitalet janë të stërmbushura dhe se numri i pacientëve me sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare në këtë periudhë është zmadhuar për 30-40%.

"Spitalet janë stërmbushur. Kjo nuk duhet të na habitë sepse kemi problem serioz me ndotjen e ajrit. Ajo që tregohet në nivel ndërkombëtar është se ndotja e ajrit nuk ndikon vetëm mbi sistemin e frymëmarrjes dhe pjesërisht mbi atë kardiovaskular, por edhe mbi të gjitha organet dhe sistemet në organizëm. Nuk ekziston



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



organ i cili nuk është në rrezik për shkak të këtyre grimcave toksike”, tha Dragan Gjorgjev, mjek në Institutin e shëndetit publik.

Nga Instituti paralajmëruan se javën e ardhshme do të mbledhet komisioni që përfshinë mjekët dhe ekspertë nga Ministria e Shëndetësisë dhe ajo të mjedisit jetësor, i cili do të vendosë çfarë masa kundër ndotjes do të ndërmerren. Nuk përjashtohet mundësia që të merret vendim për ndërprerjen e punës nëpër çerdhe dhe shkolla, ndërsa të lirohen punëtorët të cilët punojnë në ambient të hapur. Në Maqedoni rreth 1.000 njerëz vdesin në nivel vjetor për shkak të ndotjes së ajrit, ndërsa në përmasa botërore numri është 3 miliona njerëz.



## Projekt për zvogëlimin e CO2 nga automobilat

Në Shkup sot do të shënohet fillimi i projektit, qëllimi i së cilit është zvogëlimi i emisioneve të CO2 nga automobilat në Maqedoni...



Projekti është titulluar "Stabilizim i emisioneve të gazrave të qelqtë nga qarkullimi rrugor përmes zvogëlimit të dyfishtë të konsumit të karburantit: zbatim rajonal i nismës globale për ekonomi të karburantit" dhe duhet të kontribuojë drejt zvogëlimit të emisioneve të CO2 nga ana e sektorit transportues (automjetet e lehta) në Maqedoni përmes përpunimit të politikave për ekonomi të karburantit.

Në ngjarje është paralajmëruar fjalim i ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Nurhan Izairi.

Projekti zbatohet nga UNEP-GEF në bashkëpunim me Qendrën rajonale për mjedis jetësor - Zyra në Maqedoni, ndërsa shfrytëzuesi kryesor është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, e cila së bashku me rafinerinë OKTA e ka siguruar bashkëfinancimin nacional të projekteve./mia



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Izairi për ndotjen: Mobilizim i përgjithshëm, komunat të përfshihen

Secili prej nesh mund të kontribuojë në ndotjen e ajrit, pasi një prej ndotësve më të mëdhenj, krahas kompanive, janë edhe automjetet dhe amvisëritë...



Në kohën kur disa qytete të vendit përballen me ndotjen e lartë të ajrit, është me rëndësi të madhe një mobilizim i përgjithshëm si nga institucionet ashtu edhe qytetarët. Kështu deklaroi ministri i Ambientit, Nurhan Izairi, sipas të cilit një pjesë e madhe e kompetencave, që kanë të bëjnë me masat për mbrojtje nga ndotja e ajrit, u takojnë komunave, ndërsa Ministria u ka dhënë atyre rekomandimet se çfarë duhet të ndërmerret në rastet kur

për pesë ditë me radhë kemi ndotje të lartë.

***“Është mirë që këtë pyetje t’ua bëni kryetarëve të komunave se çka do të ndërmerret, sepse një pjesë shumë e madhe e përgjegjësive, siç e dini, u takon kryetarëve të komunave, që të harmonizohen me planin operativ dhe të kenë planin se si duhet të dalin nga kjo situatë. Ne i kemi dhënë sugjerimet se cilat hapa duhet t’i ndërmarrë komuna në rastet kur 5 ditë radhas tejkalohet ndotja dhe cilat nëse tejkalohet për 10 ditë me radhë”***- deklaroi ministri i Ambientit Jetësor, Nurhan Izairi.

Izairi njëherit paralajmëroi se më 17 dhjetor do të mbahet një takim me të gjithë kryetarët e komunave që kanë probleme me ndotjen e lartë të ajrit, ku do t’u jepen udhëzime se si me problemin e ndotjes janë përballur vendet më të zhvilluara.

Ajri është i ndotur edhe në Paris dhe Londër, por atje kontributin e tyre e japin edhe qytetarët. Prandaj kur “Jugohromi” punon me vetëm 20% të kapacitetit dhe Tetova përsëri ka nivel të lartë të ndotjes, ashtu si edhe Shkupi, Kërçova dhe Manastiri, ministri Izairi apelon që t’i lëmë automjetet në shtëpi dhe në punë të udhëtojmë me transportin urban. (Gyltene Sinani, TVM2)